




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 22 prill 2026**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_3207\_2026**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 , Nenin 25, Nenin 26 dhe nenin 42 paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Nenin 8 paragrafët 1, 2, 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081); dispozitat e Rregullës Nr. 03/2020 dhe Metodologjisë për Përgatitjen e Bilanceve të Energjisë; kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) Nr. 3039, të datës 13/11/2025 për shqyrtim dhe aprovim të Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike për vitin 2026,

në seancën e mbajtur me datë 22 prill 2026, nxori këtë:

## **V E N D I M**

### **I. APROVOHET - Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike për vitin 2026**

#### **A r s y e t i m**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13/11/2025 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2026** nga KOSTT Sh.A.
- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike paraqet planin vjetor të shpenzimit të energjisë elektrike në raport me energjinë elektrike në dispozicion. Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike bazohet në nevojat e planifikuara të konsumit të energjisë elektrike për vitin 2026, i cili është parashikuar të furnizohet nga gjenerimi vendor dhe importi i energjisë elektrike. Po ashtu në bilanc parashikohet edhe eksportimi i tepricave të energjisë elektrike.
- Qëllimi kryesor i Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike është që të projektojë përmbushjen e nevojave të konsumatorëve me energji elektrike, në sasi të mjaftueshme gjatë vitit, duke angazhuar kapacitetet e prodhimit dhe transmetimit në mënyrën sa më të mirë tekniko-ekonomike.
- ZRRE pas vlerësimit të dokumentit ka paraqitur qëndrimet propozimet dhe ndryshimet e nevojshme rreth këtij dokumenti, ku pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve të palëve, dokumenti është propozuar për shqyrtim dhe aprovim.



- ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të dokumentit ka konsideruar se janë përmbushur kriteret për aprovim, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2026**

**Bordi i ZRRE-së,**

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji